

Nr. 6687 PROT. DATE 10.09.2008  
3

MIRATOI

MINISTRI

GEMC RULI



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË AKSIONARE

QENDRA E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE TREGTARE (QPET) SH.A

Akti i Themelimit dhe Statuti

i Shoqërisë Aksionare

Qendra e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare (QPET) Sh.a



Në këtë Statut shprehjet vijuese do të kenë këtë kuptim:

- "Ligji Tregtar" është Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Ligji i QPET është Ligji Nr. 10134 datë 11.05.2009 "Për krijimin e Qendrës së Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare";
- "Statuti" është statuti i Shoqërisë Qendra e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare (QPET) Sh.a;
- "Shoqëria" është Shoqëria Aksionare Qendra e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare (QPET) Sh.a;
- "Aksionarë" janë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë emrat e të cilëve regjistrohen në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve;
- "Ditë të Plota" në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën në të cilën është dhënë ose konsiderohet i dhënë njoftimi.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Aksionarëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit(ve) të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statutit, do të konsiderohen të kryera rregullisht në adresat e Aksionarëve kur njoftimi, kërkesa apo komunikimi është: (i) dërguar personalisht, (ii) dërguar me poste rekomande ose me kthim përgjigje ose i është (iii) dorëzuar një shoqërie ndërkombëtare të mirënjojur të shërbimit të shpejtë postar, në adresën që Aksionari ka dekluaruar pranë Administratorit(ve) të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të marra ne mënyrë te rregullt nga Aksionari në datën më të hershme ndërmjet: (i) datës së marrjes efektive ose refuzimit te pranimit nga ana e marrësit ose (ii) një ditë pasi marrësi është informuar



për depozitimin e njofimit në zyrën vendore të shoqërisë përkatëse ndërkombëtare të mirënjohur të shërbimit të shpejtë postar.

Të gjitha njofimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti mund tă kryhen me mjete elektronike. Njofimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas legjislacionit mbi nënshkrimin elektronik dhe u dërgohen Aksionarëve në adresat elektronike të deklaruara prej tyre. Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njofimet do ti drejtohen përfaqësuesit të Bashkëzotëruesve.

Në kuptim te këtij Statuti, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, me përashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe. Përemri vëtor "ai" përfshin edhe përemrin vëtor "ajo" dhe përemri vëtor "ata" i nënkuption të dyja gjinitë, me përashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe.

#### **Kreu I -Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

##### **Neni 1:**

##### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më datë 10.09.2009 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri aksionare me emrin -

##### **Qendra e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare (QPET) Sh.a**

(2) Themeluesit e Shoqërisë janë në përputhje me Ligjin e QPET janë:

1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë (në vijim quajtur "METE"), dhe
2. Dhomë e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (në vijim quajtur "Dhoma");

##### **Neni 2:**

##### **Objekti**

Shoqëria do tă kryejë aktivitetin e organizimit të panaireve të përgjithshme, panaire kobëtare, ndërkombëtare dhe të specializuara, si dhe ekspozita tregtare. Shoqëria do tă gjithashtu çdo aktivitet ndihmës të aktivitetit kryesor, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe Ligjit të QPET.



**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar, duke nisur nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 4:  
Selia, Adresa e fakes së internetit dhe Adresa Elektronike**

- (1) Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Fushë – Krujës, pranë ish – Institutit të Kërkimeve Foragjere.
- (2) Shoqëria do të ketë Website-in e saj zyrtar.
- (3) Shoqëria do të ketë adresat e saj zyrtare për komunikimet elektronike.
- (4) Shenjet dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të Website mund te njoftohen vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (5) Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të Shoqërisë mund te registrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale.

**Kreu II -Kapitali i Regjistruar**

**Neni 5:  
Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërise është 474.000.000 Lekë, i ndarë në 474 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000.000 Lekë secila.
- (2) Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

1. Aksionari themelues METE:
  - Iloji i kontributit: në natyrë - Pasuri e Paluajtshme sipas Ligjit QPET
  - vlera e kontributit: 74.121.100 leke
  - numri i aksioneve 74.121
  - Pjesemarrja ne perqindje ne shoqeri 15.64%

2. Aksionari themelues Dhoma:
  - Iloji i kontributit: në Para
  - vlera e kontributit: 399.880.000
  - numri i aksioneve 399.88
  - Pjesemarrja ne perqindje ne shoqeri 84.36%



(2) Kalimi dhe shlyerja e kontributeve bëhet sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar. Raporti i vlerësimit për kontributet në natyrë depozitohet në QKR së bashku me këtë Statut.

**Neni 6:**

**Kërkesa për të paguar aksionet dhe térheqja e aksioneve të papaguara**

(1) Administratorët mund t'ju kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan Shoqërisë shumën e kërkuar për aksionet e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtuara atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të janë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

(3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papagar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

(4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën tridhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast se mosbatimi të tij, pasojet ligjore do të janë ato të parashikuara në paragrin 2 dhe 3 të nenit 124 të Ligji Tregtar.

(5) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit te parashikuar në nenin 124, paragrafi 3, aksioni me të cilin lidhet njoftimi mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

(6) Anulimi i aksionit sjell zgjelimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë, në përputhje me parashikimin e nenit 186 të Ligji Tregtar.

(7) Personi, aksionet e të cilit janë anuluar, humbet cilësinë e aksionarit lidhur me këto aksione por do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për të gjitha kontributet që do të



shlyheshin nga ky aksionar ndaj shoqërisë në datën e anulimit të aksioneve së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të aksioneve.

(8) Kur shlyerja e kontributeve në para sigurohet nga një garanci sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar, shlyerja e kontributeve behet sipas afateve të garancisë.

**Neni 7:**

**Llojet e Aksioneve, Obligacioneve, të Drejtave dhe Kufizimeve**

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligji Tregtar dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së aksionarëve.

(2) Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të kualifikuar votash, mund të vendosë emetimin e obligacioneve të cilat u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i kthyer në aksione ose të drejtën e parablerjes për aksionet (obligacionet e kthyeshme) dhe obligacionet që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e zotëruesve të tyre në ndarjen e fitimeve në dobi të aksionarëve (obligacionet me pjesëmarrje në fitim).

**Neni 8:**

**Çertifikatat e aksioneve**

Secili aksionar, që zotëron aksione, ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase nga ai të zotëruara, me pagesën e një shume që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për aksionet e zotëruara bashkërisht nga disa personave dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj te gjithë zotëruesve të aksioneve, në përputhje me nenin 121, paragrafi 1, të Ligji Tregtar. Emrat e zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të renditen në çertifikatën e aksionit.

**Neni 9:**

**Regjistri i Aksioneve**

Administratorët janë përgjegjës për krijimin e funksionimin e regjistrimit te aksioneve, në përputhje me nenin 119 të Ligji Tregtar.

**Neni 10:**

**Kalimi me Kontratë i Aksioneve**



- (1) Kontrata e kalimit të aksionit bëhet me shkrim dhe sipas formalitetave të përcaktuara nga Ligji Tregtar. Kalimi ka efekt ndaj shoqërisë vetëm pas regjistrimit të kontratës e aksionarit të ri në regjistrin e aksioneve. Administratorët regjistrojnë kontratën e kalimit të aksioneve pranë organeve të tjera publike sipas përcaktimeve të Ligjit Tregtar e dispozitave të tjera ligjore.
- (2) Kalimi i Aksioneve i nënshtronhet kryerjes së formalitetave të së drejtës së parablerjes sipas këtij Statuti.
- (3) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë procedura në përputhje me Ligjin Tregtar, për kryerjen e regjistrimeve në regjistrin e aksioneve.

#### Neni 11: E Drejta e Parablerjes

- (1) Nëse një prej aksionarëve të Shoqërisë do të transferojë (Aksionari Transferues) një pjesë apo të gjitha aksionet e zotëruara prej tij (Aksionet e Ofruara) një personi të tretë, atëherë ai është i defyruar t'ia ofrojë më parë për blerje aksionarëve të tjerë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim (Njoftimi i Transferimit) ku të përbahet:
- emri i personit të tretë,
  - arsyet e transferimit,
  - çmimi i shitjes për Aksionet e Ofruara, apo shënim qe aksionet transferohen pa pagesë,
  - kushtet e pagesës, si dhe
  - çdo kusht tjetër të zbatueshëm në lidhje me transferim.
- (2) Një kopje e Njoftimit të Transferimit i dërgohet dhe Administratorëve.
- (3) Aksionari që në mënyrë të pakushtëzuar pranon sipas parashikimeve të këtij nenit, të blejë të gjitha Aksionet e Ofruara sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit, do të ketë të drejtën të blejë Aksionet e Ofruara duke u preferuar ndaj çdo të treti ndaj çdo të Treti (e Drejta e Parablerjes).
- (4) Nëse në vijim të një Njoftimi Transferimi, një apo më shumë nga Aksionarët e tjerë të Shoqërisë dëshiron të fitojë aksionet e Ofruara, atëherë Aksionet e Ofruara Aksionari që do të ushtrojë të drejtën e Parablerjes (Aksionari Pranues) është i defyruar që jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë të Plota nga data e marrjes së Njoftimit të Transferimit, të njoftojë me shkrim Aksionarin Transferues mbi ushtrimin e të Drejtës së Parablerjes duke pranuar në mënyrë të pakushtëzuar blerjen e Aksioneve të Ofruara sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit (Njoftimi i Pranimit). (5) Një kopje e Njoftimit të Pranimit i dërgohet dhe Administratorëve. E Drejta e Parablerjes nuk mund të ushtronhet për vetëm një pjesë të Aksioneve të Ofruara.



(6) Nëse ka më shumë se një Aksionar Blerës, atëherë e Drejta e Parablerjes mbi Aksionet e Ofruara ushtrohet mes tyre proporcionalisht, sipas raportit të zotërimit të kapitalit të Shoqërisë (**Transferimi Proporcional**)

(7) Aksionari Transferues dhe Aksionari Pranues duhet të nënshkruajnë kontratën për kalimin e Aksioneve të Ofruara, sipas çmimit dh kushteve të tjera të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit, jo më vonë se 45 (dyzetë e pesë) Ditë të Plota nga data e marres së Njoftimit të Pranimit nga Aksionari Transferues. Në rast Transferimi Proporcional, afati si më sipër llogaritet i veçuar për çdo Aksionar Pranues, dhe kontrata për kalimin e aksioneve lidhet veçmas me secilin prej tyre.

(8) Mosnënshtimi apo refuzimi i kontratës për kalimin e Aksioneve të Ofruara, sipas çmimit dh kushteve të tjera të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit nga Aksionari Pranues, me përjashtim të rasteve kur kjo vjen si pasojë e veprimeve me faj të Aksionarit Transferues, do të konsiderohet si heqje dorë nga e Drejta e Parablerjes nga ana e Aksionarit Pranues, dhe Aksionari Transferues do të jetë i lirë të transferojë Aksionet e Ofruara pale të tretë, me të njëjtat kushte të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit. Në rastin e Transferimit Proporcional, mosnënshtimi i kontratës nga një Aksionar Pranues, nuk cënon të Drejtën e Parablerjes për Aksionarët e tjerë, dhe do t'i japë të drejtën këtyre aksionarëve, proporcionalisht sipas raportit të zotërimit të kapitalit të shoqërisë, të zëvendësohen automatikisht e pa formalitetë në pjesë e aksionarit dorëheqës, pa qenë e nevojshme të ripërsëritet procedura e njoftimit sipas këtij nenit.

(9) Procedura e njoftimit të transferimit të aksioneve sipas këtij neni duhet të ripërsëritet, nëse Aksionari Transferues, pas kalimit të afatit te pranimit, refuzimit të lidhjes së kontratës apo heqjes dorë nga e Drejta e Parablerjes nga aksionarët e tjerë, do të transferojë Aksionet e Ofruara një pale të tretë, me kushte të ndryshme nga ato që u njoftuan nëpërmjet Njoftimi i Transferimit.

(10) Çdo veprim për kalimin e aksioneve në kundërshtim me dispozitat e këtij neni në favor të një pale të tretë, do të jetë e pavlefshme, dhe do të përbëjë shkelje të detyrimit të besnikërisë nga Aksionari Transferues, i cili do te mbajë pasojat e përcaktuara nga Ligji Tregtar.

#### Neni 12:

#### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

(1) Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit kryhet sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(2) Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpresa se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligji Tregtar. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zoterojnë përpresa ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditëve.



### Kreu III - Asambleja e Përgjithshme

#### Neni 13:

##### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët, të paktën dy herë në vit. Këshilli Mbikëqyrës mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara në nenin 136 të Ligji Tregtar. Administratorët thérresin menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rast se kërkohet nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139, paragrafi 1, të Ligji Tregtar.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(3) Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme janë të pavlefshme në rast mungese të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur Shoqëria provon se personi i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë.

#### Neni 14:

##### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumi të parashikuar nga nen 144 i Ligji Tregtar. Aksionarët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 142 të Ligji Tregtar.

(2) Këshilli Mbikëqyrës cakton një Administrator si Kryetar të mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

(4) Administratori ose anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

(5) Kryetari, me pëloqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në pajtim me kuorumin e caktuar me Ligji Tregtar, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar



rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përparrë kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Ne rast te kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përparrë ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund te kërkohet nga:

1. Kryetari; ose
2. aksionarët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i aksionarit ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë aksionari.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një aksionari, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit te votave pro dhe kundër vendimit.

**Neni 15:**

Votimi

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga aksionet, çdo aksion i jep aksionarit (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose aksionarit (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

**Neni 16:**

Votimi me Prokurë

(1) Përfaqësuesi do të emërohet nga një pjesëmarrës në mbledhje sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët):

".....ShA.....

Unë/Ne l/të nënshkruari/t, ..... ne cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj(me) ....., ose në pamundësi të tij, .....



ne cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 20.....”.

(2) Në rastet kur dëshirohet tu jepet aksionarëve mundësia për ta udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët):

..... ShA.....

Unë/Ne i/të nënshkruari/t, ......., ne cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj(me) ....., ose në pamundësi të tij, ..... ne cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 \*pro \*kundër

Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.

(\*Fshini zgjedhjen e padëshinuar).

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më..... 20.....”.

(3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përparrë orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

(4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimave të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përparrë orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### Neni 17:

#### Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar

(1) Me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë, në pajtim me nenin 135 paragrafi të Ligjit Tregtar.



Emërimi behet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë së zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.

(2) Gjatë mandatit të tyre, ekspertet kontabël të autorizuar mund të shkarkohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme përlargimin ekspertëve kontabël të autorizuar.

(3) Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton Këshillit Mbikëqyrës ne përputhje parashikimet e Ligjit Tregtar dhe të këtij Statuti, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, përdobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

(3) Personat e mëposhtëm emërohen si Ekspertë Kontabël të Autorizuar deri në emërimin nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 135, të Ligji Tregtar.

- Paqesor Qato
- Berti Pasho

Kreu IV  
Administratorët

Neni 18:  
Emërimi i Administratorëve

(1) Këshilli Mbikëqyrës zgjedh një ose më persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare, në pajtim me nenin 158 të Ligji Tregtar. Emërimet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit Mbikëqyrës me shumicën e parashikuar nga neni 145 i Ligjit Tregtar, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Këshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorët nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontrate pune e lidhur me shoqërinë. Nëse shoqëria zgjedh më shume se një Administrator, METE si përfaqësues i Shtetit, në përputhje me Ligjin e QPET ka të drejtë të zgjedhë një Administrator, pavarësisht nga numri i aksioneve që zotëron.

(2) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si Administratorë. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e Administratorëve parashikohen në nenin 158 i Ligji Tregtar.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i Shoqërisë deri në emërimin e Administratorëve nga mbledhja e parë e Këshillit Mbikëqyrës të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):  
- Eugenia Marian Gjuraj, datelindja 07.03.1970, lindur ne Shkoder dhe banuese ne Tirane, Rr "Kavajes", Nr.16.

dhe specimenet e nënshkrimit:

**Neni 19:**  
**Kompetencat e Administratorëve**

- (1) Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga një o më shumë Administratorë persona fizik, të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar. Detynat e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund t'i u delegohen Administratorëve.
- (2) Nëse Shoqëria emëron më shumë se një Administrator, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë bashkërisht, njëri-tjetrit, Administratorët ushtrojnë veçmas të drejtat e detyrimet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Kur Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

**Neni 20:**  
**Mbarimi i Detyrës dhe Shkarkimi i Administratorëve**

- (1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se ai:
- nuk mund të mbajë këtë detyrë në bazë të dispozitiveve të Ligji Tregtar;
  - shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës në pajtim me nenet 167, paragrafi 2 dhe 158, paragrafi 7, të Ligji Tregtar;
  - ndodhet në gjendje paftësie paguese;
  - vuau ose mund të vuajë nga çrrgullime mendore;
  - jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar Shoqërinë, ose
  - në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar, ose dispozita të tjera ligjore në fuqi.

**Kreu V**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

**Neni 21:**  
**Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**



(1) Asambleja e Përgjithshme emëron të paktën tre ose më shume persona fizikë, gjithmonë në një numër tek jo me të madh se 21, ne cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në përputhje me nenet 135, paragrafi 2, pika 3, 167 paragrafi 4 dhe 155, paragrafi 2, të Ligji Tregtar. METE si përfaqësues i Shtetit, në përputhje me Ligjin e QPET në çdo rast do të përfaqësohet në Këshillin Mbikëqyrës, pavarësisht nga numri i aksioneve që zotëron.

(2) Emërimet do të janë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontrate pune e lidhur me Shoqërinë.

(3) Nuk mund te zgjidhen ne cilësinë e anëtarit te Këshillit Mbikëqyrës, Administratorët e Shoqërisë dhe të shoqërive së të njëjtë grup apo personat e lidhur me ta në përputhje me parashikimet e nenit 13, paragrafi 3 të Ligji Tregtar. Kufizimet e tjera për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës parashikohen në Nenin 156 të Ligji Tregtar.

(4) Shumica e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës duhet të janë të pavarur sipas parashikimeve të nenit 155, paragrafët 1 dhe 4 të Ligji Tregtar.

(5) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë së Këshillit Mbikëqyrës deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

(të dhënat e identifikimit):

(mbiemrat, emrat, adresat):

- Behar Male
- Bashkim Sykja
- Sokol Mati
- Ardian Poshi
- Edlira Prenga

#### Neni 22:

#### Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Komiteteve së tij

(1) Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratorët dhe kontrollon pajtueshmërinë me kërkesat e Ligji Tregtar, Ligjit të QPET dhe të Statutit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara nga Ligji Tregtar nuk mund fiu delegohen Administratorëve.

(2) Kur Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga më shume së tre anëtarë, ai mund t'i delegej kompetencat e veta një komiteti që përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit



Mbikëqyrës. Ky delegim mund të bëhet në përputhje me kushtet që mund të vendosen nga Këshilli Mbikëqyrës e mund të revokohet ose ndryshohet. Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të delegojë asnje nga detyrat të cilat i ngarkohen në pajtim me dispozitat ligjore.

(3) Në përputhje me sa me sipër, Këshilli Mbikëqyrës krijon

1. një komitet i cili përcakton standartet për emërimin e Administratorëve;
2. një komitet i cili përcakton skemën e shpérblimit dhe shpérblimin individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
3. një komitet për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të Shoqërisë.

Komititetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës shumica e të cilëve duhet të janë të pavarur.

(4) Komitetet e emërit, shpérblimit dhe kontrollit jepin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve qe duhen marre nga Këshilli Mbikëqyrës. Qëllimi kryesor i komiteve është rritja e efikasitetit të Këshillit Mbikëqyrës duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur si edhe të ndihmojnë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimmarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i komiteve nuk zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.

(5) Në veçanti, komiteti i kontrollit financiar:

1. mbikëqyr procesin e raportimit financiar;
2. mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve;
3. mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit;
4. shqyron dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertive kontabël të autorizuar ose të shoqërisë se ekspertive kontabël të autorizuar dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.

(6) Bazuar në vendimet e komisioneve të tij, Këshilli Mbikëqyrës:

1. i paraqet propozime Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me caktimin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
2. harton reportin mbi ecurinë e veprimtarisë sipas me nenit 154 të Ligji Tregtar dhe ia dorëzon atë Asamblesë së Përgjithshme;
3. harton reportin vjetor për drejtimin e brendshëm të shoqërisë dhe kualifikimin e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe e bën publik atë sipas parashikimeve të nenit 134 të Ligji Tregtar.

#### Neni 23:

#### Shkarkimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se ai:



- nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligji Tregtar duke përfshirë parashikimet e neneve 167 dhe 157.
- ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- vuan ose mund të vuajë nga çregullime mendore;
- jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar shoqërinë,
- ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij Këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe
- shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme për shkelje të dispozitave ligjore apo të Statutit
- në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar, ose dispozita të tjera ligjore në fuqi.

**Neni 24:**

**Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën një herë në 45 ditë kalendarike, apo më shpesht sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e këtyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 167 dhe 162 të Ligjit Tregtar. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë, në përputhje me kushtet e Ligjit Tregtar.

(3) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimiare.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoflohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njëloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.



#### Neni 25:

##### Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit së Këshillit Mbikëqyrës mbi çeshtje për të cilat këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, në kundërshtim ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligji Tregtar, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çeshtje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çeshtje të caktuar. Zbatohet parashikimi i nenit 13, paragrafi 2 dhe nenit 13, paragrafi 5 i Ligji Tregtar.

(2) Vota e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk gjzon të drejtën e votës.

(3) Në rast se në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës diskutohet një çeshtje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtarit të tij, çeshtja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpala përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

#### Neni 26:

##### Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

1. të gjithë takimeve te Këshillit Mbikëqyrës; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

#### Neni 27:

##### Shpërblimi i Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Shpërblimi i Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

(2) Skema e shpërblimeve si dhe shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të këshillit të mbikëqyrës, që nuk janë administratorë, së bashku me një raport përfektiv vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore sipas Ligjit Tregtar..



**Kreu VI**  
**Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

**Neni 28:**  
**Dividendët**

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligji Tregtar, Asamblesë së Përgjithshme miraton, deklarimin e shpërndarjen e dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

**Kreu VII**  
**Prishja dhe Likuidimi**

**Neni 29:**  
**Prishja dhe likuidimi**

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

**Emrat dhe nënshkrimet e Aksionarëve Themelues:**

- DHOMA E TREGTISE DHE INDUSTRISE      - PERFAQESUESJA ME AUTORIZIM  
TIRANE    I AKSIONERIT SHTET  
KRYETARI    MIMOZA KITA

GJOKE ULDEDAL

Nënshkruar më Datë



Nënshkruar më Datë





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1500 Rep.  
Nr. 535 Kol./

Tel. Zyre: +422 254 506; E-mail: alma\_noteri@yahoo.com



### V E R T E T I M N E N S H K R I M I

Ne Tirane, sot me date 10 shtator 2009 (dymije e nente), dite e enjte, para meje noterit publik Alma I. POSHI, me adresë Tirane, Rr. "S. Delvina", Nr. 57, u paraqiten:

1. **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Tirane / METE**, ne baze te Autorizim Nr. 6687/2 Prot. Tirane me 10.09.2009 perfaqesuar nga Pergjegjese Sektori e Ligjshmerise ne Drejtorene e Sherbimeve Juridike Zj. Mimoza KITA, lindur me 06 gusht 1972 ne Tirane, banuese ne Tirane, mbajtese e dokument identifikimi Pasaporte Shqiptare Nr. Z1716338 leshuar MRP date 07 janar 2006,

2. **Dhoma e Tregtise dhe Industrie Tirane / DHTI**, perfaqesuar nga Kryetari Gjokç ULDEDAJ, lindur me 03 mars 1959 ne Shkoder, banues ne Tirane, mbajtes i dokument identifikimi Pasaporte Nr. BA9383509 leshuar MB date 21-07-2009

persona madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar, me cilesine e Aksionereve themelues te Shoqersise **Qendra e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare (QPET) sh.a.**, deklaruan se Akti i Themelimit dhc Statuti, bashkangjitur te redaktuar jashtë zyre notariale jane ne perputhje me legjislacion shqiptar ne fuqi dhe shprehin vullnetin e tyre te lire e te plete, duke e nenshkuar ate regullisht para meje noteres. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK

Alma Poshi



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGETIKES  
DREJTOKA E SHERBIMEVE JURIDIKE

Nr. 6687/... Proc.

Tiranë, më 15/ 9/ 2009



### A U T O R I Z I M

Në mbështrimje të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqiperisë", Titulli II, Kreu I (përfaqësimi), ligin nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi I procedurave administrative në Republiken e Shqiperise", Nr.9901, date 14.04.2008,

"Per tregtaret dhe shoqeritë tregtarë", me cilësinë e përfaqësuarit të pronarit për pronën shtetërore, autorizoj Znj. Mimoza Kita me dotyre Pergjegjese Sektori e Ligjshmerise ne Drejtoren e Sherbimeve Juridike, te ndjekë të gjitha procedurat administrative apo ligjore, per kryimin e shoqerise aksionere Qendra e Paraireve che Ekspozitive Tregtare, pranë Qendres Kombetare të Reugjistrat.

MINISTRI  
GENC RUSTEMI



ALBANIAN FEDERATIVE REPUBLIC OF ALBANIA

Passport  
Number: 11011201202204  
Name: JEMSHIL VASILIEVSKI  
Sex: Male  
Date of Birth: 06 AUGUST 1972  
Place of Birth: TIRANE  
Nationality: ALBANIAN  
Signature:

Date of Issue: 06 JANUARY 2006  
Place of Issue: TIRANE  
Date of Expiry: 06 JANUARY 2016  
Photo: [Redacted]  
Fingerprint: [Redacted]

11011201202204

06 JANUARY 2006

06 JANUARY 2016

ALBANIAN FEDERATIVE REPUBLIC OF ALBANIA

11011201202204  
06 JANUARY 2006  
06 JANUARY 2016  
ALBANIAN FEDERATIVE REPUBLIC OF ALBANIA



B49383509

PASAPORTË  
REPUBLIKË SË SHQIPERISË  
SHQIPTARË  
P  
Uldedaj  
Gjokë  
Shqiptare/Albanian  
03-03-1959  
Pulej, Shkodër  
21-07-2009  
M.B.  
ALB  
BA9383509  
M  
F90303051M